# DËSHMI ARKIVI

**A-441182**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Zjarret nuk shuhen me propagandë”/ Grigels Muçollari: Rama duhet të japë llogari për dështimin në këtë sezon |
| ADRESA | `https://www.cna.al/politike/zjarret-nuk-shuhen-me-propagande-grigels-mucollari-rama-duhet-te-jape-l-i473558` |
| BURIMI | cna.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 19:32:04 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 8 shtator 2026, 11:37:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `c2815b82e2ac4e1298710ab9ae53df8e8cccff87b0f819d2dc7614361d8269c1` |
| TEKSTI | `821980b61f5130b1dd9a9bdd1c453dbc6987ff326fa15a55a84311acb13f5697` |
| PAMJA | `6b00f8e105d01cf3f0f040cd4aef0deaadb132587ea6dcf3506280470eb6f914` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `30712e390eab18ddb9ae056fc68710fc38a393137cbd763f5824cef6aa255b51` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/30712e390eab18ddb9ae056fc68710fc38a393137cbd763f5824cef6aa255b51`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English

### E fundit!

x

21:06 Aktualitet

Plarent Ndreca ka zbuluar se ekziston një pushtet tjetër p...

# “Zjarret nuk shuhen me propagandë”/ Grigels Muçollari: Rama duhet të japë llogari për dështimin në këtë sezon

8 Shtator 2026, 13:37, Politikë CNA



Anëtari i Kryesisë së PD-së, Grigels Muçollari në një deklaratë për mediat ka reaguar mbi zjarret në Shqipëri, duke e drejtuar gishtin e akuzës nga qeveria dhe kryeministri Edi Rama.

Muçollari theksoi se Rama duhet të japë llogari për banesat e djegura dhe qindra hektarët e shkrumbuar nga veriu në jug.

"Pas zjarreve dramatike në Fier dhe Himarë, Edi Rama u shfaq në vendngjarje dhe u tha qytetarëve se 'ajo që nuk na vret, na bën më të fortë'. Me fjalë të tjera, Kryeministri u tha banorëve: të keni shëndetin, sepse qeveria kaq bën.

Por shkatërrimi i shkaktuar nga zjarret nuk mund të relativizohet me batuta. Përmasat e dëmit lidhen drejtpërdrejt me masat parandaluese, kapacitetet zjarrfikëse, investimet dhe reagimin e qeverisë.

Për banesat e djegura dhe qindra hektarët e shkrumbuar nga Veriu në Jug, Edi Rama duhet të japë llogari", tha Muçollari.

Ndër të tjera, Muçollari iu drejtua Ramës dhe qeverisë së tij me 9 pyetje.

"Partia Demokratike drejton publikisht këto pyetje:

Pse Shqipëria vazhdon të ketë mungesa të rënda në pajisje dhe burime njerëzore për shuarjen e zjarreve?

Përse zona të tëra mbeten ende jashtë mbulimit të këtij shërbimi jetik?

Çfarë ndodhi me dy avionët zjarrfikës? A u vunë realisht në operim dhe a kishte Shqipëria pilotë të trajnuar për përdorimin e tyre?

Ku janë 130 mjetet e reja zjarrfikëse të premtuara nga qeveria? Përse në terren vazhdojnë të qarkullojnë automjete të vjetruara, disa prej të cilave raportohen edhe pa furnizimin e nevojshëm me ujë?

Ku është fondi prej 4.3 miliardë lekësh për emergjencat civile dhe për çfarë është përdorur?

Përse fondet e buxhetit ndryshohen me akte normative dhe zhvendosen drejt qëllimeve të tjera?

Si mund të gjenden 4.2 milionë euro për spektaklin e Kanye Ëest, pothuajse sa fondi vjetor për emergjencat civile, por të mos ketë mjete të mjaftueshme kur digjen shtëpitë dhe pasuria kombëtare?", vijoi anëtari i Kryesisë së PD.

Muçollari nënvizoi se zjarret nuk shuhen me propagandë dhe as me pamjet e avionëve amerikanë që Taulant Balla ua paraqiti shqiptarëve sikur qeveria kishte ngritur një flotë të vetme mbi Dajt.

Ai theksoi se Edi Rama duhet të mbajë përgjegjësi për dështimin e qeverisë së tij, duhet të japë llogari duke dhënë dorëheqjen.

"Zjarret nuk shuhen me propagandë. Nuk shuhen as me pamjet e avionëve amerikanë, të cilat Taulant Balla ua paraqiti shqiptarëve sikur qeveria kishte ngritur një flotë të vetën mbi Dajt.

Qeveria e Edi Ramës dështoi edhe këtë sezon. Nuk mori masat e nevojshme për të mbrojtur vendin, megjithëse paralajmërimet për temperatura ekstreme dhe thatësirë të zgjatur ishin të qarta.

Qeveria nuk ekziston kur qytetarët përballen me fatkeqësinë. Nuk ekziston as pas saj, kur duhet të bëjë bilancin dhe të dëmshpërblejë familjet. Shumë qytetarë vazhdojnë të presin edhe sot kompensimin për përmbytjet dhe zjarret e viteve të mëparshme. Kjo tregon se braktisja nuk përfundon kur fiken flakët: ajo vazhdon në zyrat e shtetit.

Edi Rama duhet të mbajë përgjegjësi për dështimin e qeverisë së tij, duhet të japë llogari duke dhënë dorëheqjen.

Zjarret nuk janë një fatalitet i pamenaxhueshëm. Një qeverisje serioze dhe e përgjegjshme që punon çdo ditë në terren për parandalimin ja del tê kontrollojë dukuri të tilla. Dhe një qeverisje serioze dhe e përgjegjshme u përgjigjet me shpejtësi qytetarëve kur preken duke i dëmshpërblyer në kohën e në masën e duhur", përfundoi Muçollari./ CNA






## Të sugjeruara

Çështja e pagave të drejtësisë/ Balla zbulon datën: Ja kur do të shqyrtohet nga parlamenti

Përplasjet me Edmond Spahon/ Noka: PD i ka dhënë shumë atij

"Do të kemi dhe shumë lajmë të tjera"/ Noka zbulon detaje për vizitën e Berishës në SHBA

Shpallja non grata e Berishës/ Noka zbardh debatin me Luli Bashën

Prapaskenat e takimit Rama-Soros/ "Lirimi" i Veliajt, në qendër të diskutimeve

Noka: Zyrtarët e lartë janë arrestuar falë fakteve që ka sjellë PD-ja

Akuzat e Ahmetaj për trafik armësh/ Noka ngre alarmin: Siguria në dorë të një grupi mafiozësh

"Ripërtëritja nuk ka përfunduar"/ Noka e zbulon: Ja çfarë do të ndodhë me PD-në në vjeshtë

Kur bie Rama?

“Regjimet nuk munden kurrë me votë”/ Noka: Sot gjenerata Z është në protestë

"Nëse mbahen zgjedhje të lira, Rama nuk fiton përballë PD-së"/ Noka: Sot, parti e parë për vota janë bandat

Sulmet ndaj PD/ Flamur Noka: U bë luftë e ethshme nga pushteti për ta kapur

"Skandali i trafikut të armëve"/ Këlliçi: Rama dhe Nufi të dorëhiqen, SPAK të nisë hetimet

"Mirëseardhja në Tiranë"/ Rama zhvillon takim me ambasadoren e re të BE-së

Varrimi i Ratko Mlladiç/ Berisha: Mbështetja e hapur për gjenocidin nga Vuçiç, sfidë ndaj qytetërimit

Vizita në SHBA/ Berisha zhvillon takim me kongresmenin Keith Self

Nisma “Prania Besnike”/ Zaganjori: Garda e vjetër e PS nuk bëhet makiazhi propagandistik i Ramës

Sot, seanca e parë e sesionit të ri parlamentar/ Jashtë Kuvendit pritet protestë

Deklaratat e Ahmetaj për trafikun e armëve/ Këlliçi: Hetime të menjëhershme nga SPAK

"Jo sekserë"/ Gazetari përplaset me Sara Milën: Takimet deputetë-qytetarë janë detyrim, jo revolucion politik

editorial

17:34 Editorial

Pse Gjykata e Lartë nuk duhet ta lirojë nga burgu Erion Veliajn?

CNA LIVESTREAM




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.